



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 37, datë 28.02.2019

PËR
PRAKTIKËN PROFESIONALE
TË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË TË SHKOLLËS SË
MAGJISTRATURËS

Në mbështetje të neneve 14 dhe 33 të Ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi kërkesën, informacionin dhe materialet e dërguara nga Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Të caktojë/miratojë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si gjykatat që do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magjistratë, profili gjyqtar, të vitit akademik 2017-2018, 2018-2019 dhe 2019-2020.
2. Të caktojë/miratojë magjistratët gjyqtarë udhëheqës për një periudhë trevjeçare (2017-2020), me të drejtë riemërimi, sipas listës bashkëngjitur.
3. Magjistratët gjyqtarë udhëheqës sipas pikës 2 të këtij vendimi, të angazhohen menjëherë për të ndjekur trajnimet e nevojshme pranë Shkollës së Magjistraturës.
4. Të caktojë, për periudhën 1 mars 2019 - 30 qershor 2019, magjistratët gjyqtarë udhëheqës, për kandidatët për magjistratë, profili gjyqtar, për vitin akademik 2018-2019, sipas listës bashkëngjitur.
5. Magjistrati gjyqtar udhëheqës do të bëjë vlerësimin etik dhe profesional të secilit kandidat magjistrat, profili gjyqtar, sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi, duke u bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit, të përcaktuara në ligj.
6. Magjistrati udhëheqës gjyqtar, sipas pikës 4 të këtij vendimi, të përjashtohet nga hedhja e 10-të e shortit, të organizuar gjatë periudhës 1 mars 2019 - 30 qershor 2019, për ndarjen e çështjeve në gjykatën pranë të cilës ushtron funksionin.

7. Magjistrati gjyqtar udhëheqës, përgjatë periudhës përkatëse që ushtron këtë veprimtari, përfiton 5 për qind shtesë page mbi pagën mujore bruto fillestare të tij. Shtesa e pagës për magjistratin gjyqtar udhëheqës i shtrin efektet nga data 1 janar 2019.
8. Gjatë praktikës profesionale, kandidati për magjistrat, profili gjyqtar, gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara në kohëzgjatjen 25 ditë pune, nga të cilat, 15 ditë pune merren gjatë muajit gusht, në të njëjtën kohë me magjistratin udhëheqës. Kryetari i gjykatës jep pushimet vjetore, pasi konsultohet me magjistratin gjyqtar udhëheqës të tij.
9. Për këtë vendim njoftohen Shkolla e Magjistraturës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe magjistratët gjyqtarë udhëheqës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PËR
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**